




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Zyra e kryetarit/Kancelarija predsednika/Major's office

Nr.02/ 66

Datë: 7.2.2024

Në mbështetje të neneve 13, 17 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, në pajtim me dispozitën e nenit 6 të Rregullores Nr. Npi - 01/461 të datës 27.12.2023 për Procedurat dhe Kriteret për Zgjedhjen e Laureatëve të Vitit në Sport si dhe sipas nenit 54 të Statutit të Komunës së Shtimes, Kryetari i Komunës merr:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni për vlerësimin dhe zgjedhjen e e Laureatëve të Vitit 2023 në Sport në Komunën e Shtimes.
2. Anëtarë të Komisionit sipas pikës 1 të dispozitivit caktohen:
 1. Arben Deliu – kryesues
 2. Ilirijana Arifi - anëtare
 3. Faruk Mehmeti - anëtar
 4. Shqipe Baftiu - anëtare
 5. Zenel Shabani – anëtar.
3. Anëtarët e Komisionit për vlerësimin dhe zgjedhjen e sportistit të vitit 2023 në Komunën e Shtimes i kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre sipas legjislacionit në fuqi dhe në respektim të parimeve të transparencës, ndershmërisë dhe objektivitetit.
4. Mandati i Komisionit është i vlefshëm deri në përfundimin e procedurave sipas qëllimit të nxjerrjes së këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrim.

Iu dërgohet:

Anëtarëve të Komisionit

Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Arkivit

